

VENDIM
Nr. 573, datë 8.10.2025

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË NDRYSHIMIT NUMËR 1 TË
PROTOKOLLIT ZBATUES, NË LIDHJE ME ASISTENCËN FINANCIARE,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 45/2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të ndryshimit numër 1 të protokollit zbatues, në lidhje me asistencën financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 45/2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROTOKOLLI I NDRYSHIMIT NUMËR 1
I PROTOKOLLIT ZBATUES, NË LIDHJE ME ASISTENCËN FINANCIARE,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim referuar si “Pala” individualisht dhe “Palët” bashkërisht),

Me dëshirën për të bërë ndryshime të nenit-II (Objekti), nenit-III (Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit) dhe nenit-IV (Parimet e zbatimit) të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare, i cili ka hyrë në fuqi më datë 3 shtator 2020,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni-I

Neni-II (Objekti) i Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohet si më poshtë.

“Asistenca Financiare që do të ofrohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë përfshin shpenzimet për transportin, ushqimin dhe akomodimin dhe tarifat e trajnimit/kursit për personelin e Gardës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrin pjesë trajnime/seminare/konferenca/*workshop*-e/kurse që zhvillohen/bashkërendohen nga Qendra e Trajnimit “Partneriteti për Paqe”, Qendra Ekselencës për Luftën kundër Terrorizmit, Qendra e Ekselencës për Sigurinë Detare dhe qendrat e trajnimit pranë strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, si dhe shpenzimet për transportin, ushqimin dhe akomodimin e personelit të Gardës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat, në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe, do të marrin pjesë në vizita ushtarake zyrtare në Republikën e Turqisë dhe veprimtari të tilla, si: stërvitje, trajnime dhe ekzekutime të përbashkëta që do të zhvillohen në Turqi nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë.”

Neni-II

Neni-III (Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit) i Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohet si më poshtë.

“Ky Protokoll zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për këtë Protokoll janë Zyra e Atasheut Ushtarak/Ambasada e Republikës së Turqisë, e akredituar në Republikën e Shqipërisë, dhe Zyra e Atasheut Ushtarak/Ambasada e Republikës së Shqipërisë, e akredituar në Republikën e Turqisë.”

Neni-III

Pikat 1 dhe 3 të Nenit-IV (Parimet e zbatimit) të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohen si më poshtë:

“1. Fondi prej 3.500.000 TL (tre milionë e pesëqind mijë lira turke) do të alokohet i shtrirë në vite dhe në përputhje me kuadrin e legjislacionit kombëtar dhe shpërndarjet e buxhetit vjetor të Republikës së Turqisë.”

“3. Asistenca financiare që do të transferohet në llogarinë bankare të Zyrës së Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë akredituar në Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë, përdoret nën mbikëqyrjen e Zyrës së Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë akredituar në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të udhëzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë.”

Neni-IV

1. Ky Protokoll është pjesë plotësuese e Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij Protokollit Ndryshimi.

2. Për kohëzgjatjen dhe përfundimin e këtij Protokollit zbatohen dispozitat e nenit IX të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare.

Neni-V

Ky Protokoll përgatitet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze, ku secila kopje është (njëlloj) autentike. Në rast mosmarrëveshjes që mund të lindin nga zbatimi i këtij Protokollit, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

Në dëshmi të sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë përfaqësues të autorizuar rregullisht të të dyja Palëve, kanë nënshkruar këtë Protokoll më, në Istanbul, dhe më....., në 23.7.2025.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

NËNSHKRIMI

EMRI: Pirro VENUGU

POZICIONI: Ministër i Mbrojtjes

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

NËNSHKRIMI:

EMRI: Yaşar GÜLER

POZICIONI: Ministër i Mbrojtjes Kombëtare